



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 971/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Latif Latifi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë, paraqitur kundër vendimit pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga e Latif Latifi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Mitrovicë me shenjën ZL.Anr.971/2017, të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.971/2017 me datën 10.11.2017, nga parashtruesi i apelit Latif Latifi, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Mitrovicë në të cilin thekson se në qendrat e votimit QV 1127b, 1103b, 1111b, 1112b, 1113b, 1117b, 1121b, 1132b, 1116b i mungojnë votat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së apelit si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të apeluesit gjeti se apeli është i pabazuar sepse nuk është specifikuar Vendvotimi i saktë se ku kanë ndodhur parregullsitë, dhe me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar se sa vota i mungojnë. Prandaj Paneli apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindës pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si tillë apeli u refuzua.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.971/2017 më datën 12.11.2017.



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*